

**ARDIAN MUHAJ**

**KONTRIBUTI I DETARËVE SHQIPTARË NË ZBULIMET  
E MËDHA GJEOGRAFIKE  
(SHEK. XV-XVI)**

Edhe pse shqiptarët janë një popull që gëzon një pozitë strategjike, duke pasur dalje në dy nga detet më të rëndësishme të Mesdheut Qendror, atyre u është atribuar një rol i kufizuar në historinë detare të Mesjetës. Në fakt, bëhet fjalë më tepër për një perceptim, që buron nga mungesa e studimeve specifike mbi marrëdhëniet e shqiptarëve me detin. Përndryshe, dokumentacioni jo i pakët provon se shqiptarët janë të pranishëm në historinë detare jo vetëm të Mesdheut por edhe të Atlantikut dhe të Europës Veriore që në Mesjetën e Vonë, në të njëjtën kohë me popullsi të tjera me traditë detare.

Duke u mbështetur në hulumtimet e deritanishme ne mendojmë se bashkëveprimi i kufizuar i shqiptarëve me detin është plotësisht i kuptueshëm dhe i shpjgueshëm. Nga të dy detet që lagin brigjet shqiptare, padyshim që Adriatiku ka rëndësinë më të madhe. Për të kuptuar raportet e popullsisë që ndajnë brigjet e këtij deti, duhet konsideruar historia e luftës për dominimin e tij. Gjatë shekujve të Mesjetës, veçanërisht ndërmjet shek. XIII-XV, ky det shndërrohet në një “gji” venedikas.<sup>1</sup> Mbizotërimi i Venedikut në këtë hapësirë detare merr përmasat e një monopoli deri në atë pikë sa që ky shtet e konsideron Adriatikon si det të brendshëm, duke pretenduar edhe të drejtën ekskluzive të lundrimit në det të hapur.<sup>2</sup> Ky monopolizim i hapësirës

<sup>1</sup> Mes Vlorës dhe S. Maria di Leuca në Pulja kalon vija imagjinare që shënonte kufirin e “Gjirit të Venedikut”. Për herë të parë ky term del në shek. X tek një autor arab, Ibn Hawqal, *ġûn al-banâdiqîn*. Edhe osmanët e vazhduan traditën duke e quajtur *Venedik Körfezi*. M. Pia Pedani, “Gli ottomani in Adriatico tra pirateria e commercio”, *I Turchi, gli Asburgo e l’Adriatico*, a cura di Gizella Nemeth e Adriano Papo, Trieste: 2007, f. 57.

<sup>2</sup> Venediku e konsideronte Adriatikon si zonë të vetën të sigurisë deri aty sa i konsideronte anijet e armatosura që hynin në “gji” si anije korsare. Më 1347 Senati u përgjigjej të dërguarve të Markes e Fermos se “securitatis maris in quo dicatur quod spectat ad honorem nostrum”. *Venezia-Senato. Deliberazioni miste. Registro XXIV*

detare adriatikase, kufizonte marrëdhëniet dhe bashkëveprimin me detin jo vetëm të shqiptarëve por edhe të popujve dhe njërive të tjera politike që gjeografikisht ndanin brigjet e këtij deti. Këtë fakt e ilustron më së miri rasti i Raguzës, që edhe pse ishte themeluar si port dhe që bazën e vet ekonomike e kishte të lidhur kryekëput me shfrytëzimin e detit, nuk arriti të zhvillojë potencialin e vet detar deri në fundin e shek. XIV. Kjo u bë e mundur vetëm atëherë kur ajo u vendos nën suzerenitetin e kurorës hungareze, duke gjetur në këtë mënyrë mbrojtjen ndaj politikës ekskluziviste (përjashtuese) venedikase.<sup>3</sup> Raguzja njohu që prej kësaj kohe e deri në shek. XVII periudhën e vet të artë, duke u shndërruar në një nga qytetet më të pasura e të zhvilluara të Mesdheut.<sup>4</sup> Këtë problem e bën akoma dhe më të qartë rasti i Ankonës, i cili ishte porti italian më i rëndësishëm që konkurronte Venedikun në Adriatik dhe megjithatë nuk i rezistoi presionit venedikas.<sup>5</sup>

(1347-1349), a cura di Ermanno Orlando, vëll. 11, Venezia: Istituto Veneto di Scienze, Lettere ed Arti, 2007, nr. 101, fl. 11v.

<sup>3</sup> Rivaliteti ndërmjet Venedikut dhe Hungarisë për Dalmacinë përfundoi më 1358 me fitoren e Hungarisë. Zdenka Janeković Romer, *Višegradski ugovor temelj Dubrovačke Republike*, Zagreb: Golden marketing, 2003, f. 64-68; Zrinka Pešorda-Vardić, “The Crown, the King and the City: Dubrovnik, Hungary and the Dynastic Controversy, 1382-1390”, *Dubrovnik Annals* 10, Dubrovnik: 2006, f. 9.

<sup>4</sup> Bariša Krekić, *Dubrovnik and Spain: Commercial and Human Contacts, Fourteenth-Sixteenth Centuries*, in *Iberia and the Mediterranean World of the Middle Ages. Essays in Honor of Robert I. Burns S. J.*, Leiden: Brill, 1996, II, f. 396-397; Francis W. Carter, “The Commerce of the Dubrovnik Republic, 1500-1700”, *The Economic History Review*, 24/1, London: 1971, f. 370.

<sup>5</sup> Tregtia e Ankonës hyri në krizë vecanërisht mbas konfliktit që u mbyll me një marrëveshje nënshtruese për të më 1264. Rowan W. Dorin, “Adriatic Trade Networks in the Twelfth and Early Thirteenth Centuries”, në *Trade and Markets in Byzantium*, ed. Cécile Morrisson, Dumbarton Oaks Research Library, f. 210, 267; Megjithatë që në fillimin e shek. XVI hegjemonia venedikase në Adriatik dhe më tej po venitej. John E. Dotson, “Foundations of Venetian Naval Strategy from Pietro II Orsello to the Battle of Zonchio”, *Viator*, 32, Los Angeles: 2001, f. 125. Kjo prirje del fare qartë edhe në rastin e Karl Topisë më 1364, kur deshi të ndërtojë një flotë me bazë në Kepin e Pallës, Venediku ia ndaloi me ashpërsi. ASV, *Senato Misti*, 31, fl. 61v. botuar në *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*. Collegerunt et digesserunt Ludovicus de Thallóczy, Constantinus Jireček et Emilianus de Sufflay, volume II, 1344-1406, Vjenë: Adolph Holzhausen, 1918, f. 45-46, dok. nr. 197, 14 maj 1364. Shprehimisht në këtë dokument përmbledhet qëndrimi hegjemonist i Venedikut në Adriatik: “tum etiam nolemus ullo modo, quod nec ipsi Albanenses, nec alii tenerent navigia armata in mari, quia custodia istius culfi ad nos spectat et pertinent de iure”.

Në rastin e Shqipërisë kjo zonë e monopolit venedikas shtrihej edhe në brigjet jugore, ato të detit Jon.<sup>6</sup> Monopolizimi i hapësirës detare adriatikase u intensifikua gjatë shek. XV, kur Venediku për herë të parë në historinë e vet si republikë me bazë detare filloi një politikë të re, atë të zotërimit të territoreve në *terraferma* apo në brendatokë. Në këtë periudhë ai përfshiu në zotërimet e veta edhe një pjesë të rëndësishme të tokave shqiptare<sup>7</sup> dhe kontributi i detarëve shqiptarë në flotën venedikase erdhi duke u rritur. Megjithatë për faktin se Venediku përbënte rastin më tipik të një shteti që mbështetej ekskluzivisht në patriaciatin lokal, mundësia e promovimit shoqëror në bazë të meritave profesionale të detarëve shqiptarë ishte tejet e kufizuar. Ky karakter i mbyllur i strukturës shoqërore venedikase shtrihej jo thjesht në vetë qytetin e Venecias, por edhe në zotërimet e saj koloniale.<sup>8</sup> Megjithëse Venecia ishte një qytet kozmopolit, lëvizshmëria shoqërore, ishte e ngurtësuar si askund tjetër.<sup>9</sup>

<sup>6</sup> Korfuzi ishte pika strategjike që dominonte hyrjen e Adriatikut. Venediku e mori më 1386 dhe e mbajti deri në fundin e Republikës më 1797. R.W Dorin, "Adriatic Trade Networks...", f. 265.

<sup>7</sup> Përveç qyteteve shqiptare të Durrësit, Lezhës, Shkodrës, Drishtit, Ulqinit e Tivarit në Itali mori Trevison (1387), Padovan (1405), Veronën (1402), Vicenzan (1404), Bellunon (1420), Brescia (1426), Bergamo (1428), Crema (1454), Lago Garda (1441), Rovereto (1416). Në Egje mori Nauplia (1388), Lepanto (1393), Argos (1394), Patras (1408), Selanik (1423). John E. Law, "The Venetian Mainland State in the Fifteenth Century," *Transactions of the Royal Historical Society*, 6<sup>th</sup> series, II, London, 1992, f. 153-174; Oliver Jens Schmitt, "Le commerce vénitien dans l'Albanie vénitienne: mécanismes et conjonctures d'un espace économique au XV<sup>e</sup> siècle", *Anuario de estudios medievales*, 33/2, Barcelona, 2003, f. 881-883, mendon se zgjerimi i pushtetit venedikas në tokat shqiptare ishte e lidhur pikësisht me arsye strategjike dhe në radhë të dytë nga interesat ekonomike.

<sup>8</sup> Në tetor të vitit 1414, Senati përcaktonte që krerët ushtarakë në Shkodër nuk mund të ishin shqiptarë: "illi... non possint esse Albanenses". *Acta Albaniae Veneta*, Josephi Valentini labore reperta et transcripta ac typis mandata, 2/VII, Palermo- München: Rudolf Trofenik, 1969, n° 1909, f. 156; O. Schmitt, "Le commerce vénitien dans l'Albanie vénitienne", f. 885 pohon se tipi i tregtarit që ai e quan tregtar-administrator në tokat shqiptare "était toujours un patricien, car la République de Saint-Marc réservait à la classe aristocratique le droit exclusif de gérer l'administration dans l'État vénitien"; Freddy Thiriet, *Histoire de Venise*, Paris: Presses Universitaires de France, 1976, f. 45, thotë "Les charges supérieures sont réservés aux patriciens vénitiens".

<sup>9</sup> Një poet i fillimit të shek. XV e jep mjeshtërisht këtë karakter kozmopolit të saj "Venexia franca, del mondo corona,/ Donna del mare, del pian e del monte.../ Dentro si alberga d'ogni condizione/ Zente Todesca, e Italic e Lombardi.../ Franzesi e Borgognoni e molti Inglesi,/ Ongari e Schiavi, de molti paesi/ Tartari, e Mori, e Albanesi e Turchi/ Che vien con nave e burchi/ A far sua vita, e mai non se ne parte."

Kjo e shpjegon edhe faktin që shumë detarë të shquar në Venedik nuk kishin mundësi që të arrinin promovimin profesional siç ndodhte në shtetet e tjera të Europës<sup>10</sup>. Jo rastësisht, një nga detarët me origjinë shqiptare, që arriti të shquhej në historinë e detarisë europiane në gjysmën e dytë të shek. XV, aftësitë e tij nuk i shpalosi në Venedik, por në Francë. E kemi fjalën për detarin Gjergj Bua Shpata nga Koroni i Moresë, i cili u bë mësues dhe model frymëzimi për vetë Kristofor Kolombin<sup>11</sup>. Madje, ky i fundit për shumë vite kishte lundruar nën udhëheqjen e Gjergj Bua Shpatës. Bashkëpunimi i Kristofor Kolombit dhe Gjergj Bua Shpatës ndonjëherë drejtohej edhe kundër Venedikut siç ndodhi në betejën që u zhvillua në brigjet portugeze më 21 gusht 1485. Në këtë betejë katër galera venedikase të linjës së Flandrës, u shpartalluan nga Bua Shpata dhe Kolombi nën flamurin francez<sup>12</sup>.

Cituar nga Molmenti, *Venice its Individual Growth from the Earliest Beginnings to the Fall of the Republic*, London: Murray, 1906, f. 127-128.

<sup>10</sup> Një rast që e ilustron këtë është ai i Mikelit nga Rodi që me qëllim promovimin e tij në karrierën detare shkroi një vepër meritore mbi detarinë dhe ndërtimin e anijeve, megjithatë nuk ia arriti të ngrihej në detyrë. Ngjashëm me të edhe trashëgimtari i dorëshkrimit të tij, Gjoni nga Drishti ishte vetëm 'padrone giurato' (apo mbikqyrës i një numri të rremëtarëve) i pronarit Marino Dandolo në kohën kur harton testamentin e tij më 1473. Pamela O. Long, "Introduction: The World of Michael of Rhodes, Venetian Mariner", në *The Book of Michael of Rhodes. A Fifteenth-Century Maritime Manuscript*. Edited by Pamela O. Long, David McGee, and Alan M. Stahl, Vol. 3. Massachusetts-London: The MIT Press, 2009, f. 1-2.

<sup>11</sup> Vignaud, *Études critiques sur la vie de Colomb avant ses découvertes*, f. 170, thotë: «ce personnage s'appelait de son vrai nomme Georges de Byssipat... et lui-même signait G. de Byssipat» Dokumenti i natyralizimit të tij si shtetas francez, i vitit 1477, nuk përmend patronimin Paleolog, por thjesht Byssipat: «Georges de Bicepat, dit le Grec, chevalier, natif du pais de Grèce, capitaine de notre grand nef». Abbe Renet, «Les Bissipat de Beauvaisis», *Mémoires de la société académique de l'Oise*, 14, (Beauvais, 1889), f. 43. Rreth shqiptarëve në More gjatë Mesjetës shih më gjerësisht: Pëllumb Xhufi, "Albania Graeca": përmasat dhe pasojat e migrimeve shqiptare në Greqi në shek. XIV", në *Dilemat e Arbrit. Studime mbi Shqipërinë mesjetare*. Tiranë: Pegi, 2006, f. 350-356; *Cronaca dei Tocco di Cefalonia. Di Anonimo*, a cura di Giuseppe Schirò, Roma, Academia nazionale dei Lincei, 1975; Alain Ducellier, "Les Albanais dans les colonies vénitiennes au XVe siècle", *Studi Veneziani*, 10, Pisa-Roma, 1968, f. 49-50, 52-53, 56, 62; R. Loenertz, "Pour l'histoire du Péloponèse au XIVe siècle (1382-1404)", *Études byzantines*, 1, Paris, 1943, f. 152-196.

<sup>12</sup> Bilanci i kësaj beteje ishte rreth 130 detarë të vvarë dhe dyqindmijë dukate dëme. Rawdon Brown, *Calendar of state papers and manuscripts relating, to English affairs, existing in the archives and collections of Venice and in other libraries of northern Italy* [më tej: CSP, Venice], vëll. I, London: Longman Green, 1864, nr. 510.

Dokumentet e përmendin si Giorgi Bissipat, një detar me origjinë nga Greqia që lundronte nën lejen dhe flamurin e Mbretërisë Franceze. Ndërsa, i biri i Kristofor Kolombit, Fernando, e shpjegon mbërritjen e të atit në Spanjë, duke pohuar se ai ishte i shoqëruar me Bua Shpatën, nën udhëheqjen e të cilit kishte lundruar për shumë vite<sup>13</sup>. Por roli i këtij detari me origjinë shqiptare nuk kufizohet vetëm në fushatën e korsarisë, aq më tepër që në këtë periudhë kufiri mes një korsari dhe një detari të madh ishte lehtësisht i kapërcyeshëm.

Jemi të mendimit se duhet bërë një dallim i qartë ndërmjet termit pirat dhe korsar. Pirati është një detar që e ushtron detarinë me qëllim grabitjen e anijeve apo zonave bregdetare dhe nuk njeh asnjë lloj autoriteti. Ndërsa korsari është një detar që e ushtron detarinë në kuadrin e një shteti dhe me lejen e një autoriteti politik kryen operacione kundër anijeve apo vendbanimeve bregdetare të një shteti apo autoriteti të konsideruar armik.<sup>14</sup>

Lidhjet e Bua Shpatës me Portugalinë dhe me eksplorimin e Atlantikut ishin të hershme. Më 1477, Luigji XI i cakton si detyrë që të shoqërojë për në Lisbonë mbretin portugez Alfonsi V, i cili ndodhej në Francë me shpresë për të fituar mbështetjen e saj kundër Kastiljes.<sup>15</sup> Ndërsa më 1483, ai u ngarkua nga kurora franceze për të eksploruar në

<sup>13</sup> “Cuanto al principio y motivo de la venida del Almirante [lexo: Kristofor Kolombit] a España, y de haberse él dado a las cosas de la mar, fue causa un hombre señalado de su nombre y familia, llamado Colombo, muy nombrado por la mar... Hernando Colón, *Historia del Almirante*, Madrid: Historia 16, 1984, f. 58-61.

<sup>14</sup> Në këtë kuptim nuk ka ndonjë ndryshim ndërmjet korsarëve osmanë dhe atyre europianë qofshin këta në Mesdhe apo në Europën Veriore. Korsarët (*levend* apogonullu *reis*) vepronin ligjërisht në ndryshim nga piratët e paligjshëm (*harami levend*). Emrah Safa Gürkan, “The centre and the frontier: Ottoman cooperation with the North African corsairs in the sixteenth century”, *Turkish Historical Review*, 1, Brill, 2010, f. 127; Roger Coindreau, *Les corsaires de Sale*, Institut des Hautes Etudes Marocaines, Paris, 1948, f. 15.

<sup>15</sup> Dorëshkrimet që gjenden në BN de Paris, dhe që pasqyrojnë të ardhurat e tij qoftë nga thesari mbretëror qoftë nga pronat e tij në asnjë rast nuk përmendin emrin Paleolog, por gjithnjë Byssypatt, Bicepat etj. A. Renet, “Les Bissipat...”, f. 47-50 e në vazhdim. Me rastin e martesës së tij me një fisnike franceze, Marguerite de Poix, më 1479, mësojmë se ai ishte edhe komandant i kështjellës së Toucques në Rouen dhe përmes kësaj martese bëhet zot i një pjese të Troissereux, i Hannaches, Blicourt dhe Mazi. Du Cange dy shekuj më vonë e paraqet si Paleolog nga nëna dhe Dishypatos nga babai. Carolo du Fresne du Cange, *Historia byzantina duplici commentario illustrata prior familias ac stemmata imperatorum Constantinopolitanorum, etj.* Paris, 1680, kap. 62, f. 256.

oqeanin Atlantik drejt ishujve të Kepit të Gjelbër dhe Berberisë.<sup>16</sup> Informacionet rreth lundrimit në ato zona duket se i kishte marrë në fillim të viteve 1480 kur gjendej në Portugali së bashku me Kristofor Kolombin. Në këtë kohë Kolombi përpiqej të bindte mbretin portugez Zhoao II për ta mbështetur që të bënte udhëtimin e tij në Atlantik në kërkim të rrugës për në Indi. Por, Zhoao II, megjithëse nga njëra anë refuzoi të mbështesë Kolombin, nga ana tjetër dërgoi një detar portugez për të eksploruar një tokë të cilën ai betohej se e shihte çdo vit që lundronte.<sup>17</sup>

Me mbështetjen e Francës dhe nën urdhrat e Bua Shpatës rreth 300 ushtarë, ndihmësa e kuzhinierë u nisën nga porti i Honfleurit në bordin e tri anijeve.<sup>18</sup> Qëllimi i kësaj ekspedite ishte gjetja e një ilaçi për shërimin e mbretit Luis XI që besohej se gjendej në disa ishuj të gjirit të Guinesë. Në kohën që kjo ekspeditë e udhëhequr nga Bua Shpata përgatitej, arkipelagu drejt të cilit do të nisej në fakt kishte më se dy dekada që ishte zbuluar prej portugezëve.

Simbas një rrëfimi të një detari francez që ishte ndalur në një nga ishujt e arkipelagut kur po kthehej nga bregu atlantik i Guinesë, aty gjendej një ilaç i çmuar, i cili shëronte lebrën. Natyrisht një rrëfim i tillë kishte ngjallur një interes të madh në Francë. Bëhej fjalë për gjakun e breshkave të detit që dilnin në brigjet e këtyre ishujve.<sup>19</sup> Nga këta ishuj

<sup>16</sup> Më 8 korrik 1483 e dërgon drejt Kepit të Gjelbër dhe Berberisë për të kërkuar “aucunes choses qui touchoient très fort le bien et santé de sa personne”. Charles de la Roncière, *Navigations françaises au XVe siècle*, Paris: Imprimerie nationale, 1896, f. 7.

<sup>17</sup> Mbreti portugez João II refuzoi të mbështeste Kolombin, nga ana tjetër urdhëroi realizimin e një udhëtimi drejt perëndimit të portugezit Fernão Domingues do Arco, duke i premtuar dhënien në feud të një ishulli nga ato që do të zbulonte. *Descobrimientos portugueses: documentos para a sua história*, ed. João Martins da Silva Marques, III, Lisboa: Instituto de Alta Cultura, 1971, 30 korrik 1484, f. 278; Kolombi i referohet këtij monenti në ditarin e tij: “estando en Portugal el año de 1484 vino uno de la madera al rey a le pedir una caravela para ir a esta tierra que via, el qual jurava que cada año la via y siempre de una manera”. Cristóbal Colón, *Textos y documentos completos*, ed. Consuelo Varela, Madrid: Alianza Universidad, 1984, f. 18.

<sup>18</sup> A. Renet, “Les Bissipat...”, f. 23, n. 2; C. Du Cange, *Historia byzantina...*, cap. 62.

<sup>19</sup> “dans leur sang on baignait «les infectz et mallades de ladite lèpre... ilz se purgent à mengier dudit poisson et grasse de ladite tort lie, à fachon que en continuant, au bout de deux ans, ilz en sont bien guarys”. Eustache de La Fosse, *Voyage à la côte*

portugezët ruanin me kujdes të madh minierat e arit të bregut të Guinesë, ose më saktë pikat e kontaktit me banorët prej ku këmbenin mallra europiane me arin saharian.<sup>20</sup> Kjo është arsyeja pse në bordin e anijeve franceze që do niseshin në këtë ekspeditë kishte kaq shumë ushtarë, në eventualitetin e një ndeshjeje ushake me portugezët<sup>21</sup>.

Ekspedita franceze mendohet që zbarkoi në veri të ishullit të Santiagos. Ka të ngjarë që Bua Shpata të ketë qëndruar aty, me ç'rast del më 1492 me emrin Jean-Baptiste, si zot i ishullit të Majit, ose një kolon i lënë prej tij me rastin e kësaj ekspedite. Kristofor Kolombi ishte në dijeni të ngulitjes së këtij Jean-Baptiste në ishull, duke tentuar të ngulitet edhe vetë në një nga këta ishuj të mrekullueshëm.<sup>22</sup>

Pushtimi i viseve shqiptare dhe inkuadrimi i tyre në shtetin osman, si dhe islamizimi gradual i një pjese të shqiptarëve solli si pasojë përfshirjen e tyre në rrjedhat politike dhe kulturore të kësaj perandorie. Zbulimet e mëdha gjeografike të shek. XV-XVII bënë të mundur vendosjen e kontakteve mes pjesëve deri atëherë të izoluara të qytetërimit njerëzor. Në këtë aspekt shqiptarët vazhdojnë të kontribuojnë në zbulimet gjeografike, në shtimin e njohurive të njerëzimit rreth botës që e rrethonte, në afrimin e popujve dhe njohjen mes njëri-tjetrit të popullsisë deri atëherë të panjohura dhe në krijimin e urave të komunikimit ndërnjerëzor. Zbulimet gjeografike të europianëve dhe penetrimi i tyre në zonat që më parë kishin qenë të njohura vetëm përmes legjendash, shkaktoi natyrisht edhe një farë reaksioni zinxhir në shtetet myslimane, veçanërisht të Perandorisë Osmane. Shqiptarët në këtë shekull të apogjeut osman ishin të pranishëm dhe shpalosën dhuntitë e tyre deri në skajet më të largëta të këtij shteti, jo vetëm në Mesdhe por edhe në oqeanin Atlantik, në Detin e Kuq e në oqeanin Indian.

*occidentale d'Afrique, en Portugal et en Espagne (1479-1480)*, publié par Fouché-Delbosc, Paris, 1897, f. 19-20.

<sup>20</sup> Garcia de Rezende, *Chronica de D. João II*, 1607, fol. 14, cap. 23; Charles de La Roncière, "Avant Christophe Colomb". *Bibliothèque de l'école des chartes*, 61 Paris, 1900, f. 173-174.

<sup>21</sup> Më 1383 të dy Kolombot ishin kthyer nga një udhëtim në Guine, dhe ky moment mund të konsiderohet si pika e kthesës «entre le simple marin et le grand découvreur». Armand d'Avezac, "Année véritable de la naissance de Christophe Colomb, et Revue chronologique des principales époques de sa vie", *Comptes rendus des séances de l'Académie des Inscriptions et Belles-Lettres*, 16, Paris, 1872, f. 28.

<sup>22</sup> La Roncière, "Avant Christophe Colomb", f. 175-176.

Në mesin e një numri të madh shqiptarësh që në kuadrin e Perandorisë Osmane kontribuan në historinë botërore shquhen dy shqiptarë shumë të njohur dhe të famshëm në krejt Mesdheun. E kemi fjalën për dy detarë shqiptarë prania historike e të cilëve u kthye në legjendë: Muhamet Shqiptari (Mami Arnauti, Arnavud Memi) dhe kapidan Murati i Madh. Që të dy kanë jetuar në fundin e shek. XVI dhe përveçse kanë qenë miq të ngushtë me njëri-tjetrin kanë zënë vend në letërsinë spanjolle të kësaj kohe, të asaj që quhet letërsia e shekullit të artë spanjoll.<sup>23</sup> Murat Reisi, i Madhi (Morato Arraez el Grande i burimeve spanjolle) detari i famshëm i Mesdheut të shek. XVI, ishte një trim dhe aventurier i pasqor, të cilin historiani Philip Gosse e konsideron si një nga detarët më të njohur të të gjitha kohërave.<sup>24</sup> Murati ishte i pari ndër kapidanët e pavarur osmanë, që e ushtronin detarinë më shumë për llogari të vet se sa të inkuadruar në flota ushtarake dhe emri i tij u bë aq i famshëm sa edhe ai i detarit anglez Francis Drake.<sup>25</sup> Kjo edhe për faktin se edhe bashkëkohësit e tij europianë e shquanin në mesin e një morie të tërë kapidanësh detarë që mbanin emrin Murat, me epitelin i Madhi. Në bazë të dëshmive të Diego de Haedos, Kapidan Murati ishte shqiptar.<sup>26</sup> Që në moshën 12 vjeçare fillon të lundrojë nën urdhrat e

<sup>23</sup> Limitet kronologjike të kësaj epoke të artë spanjolle përfshijnë fillimin e shek. XVI e deri në dekadën e tretë të shek. XVII. R. Trevor Davies, *El siglo de oro español (1501-1621)*, Zaragoza : Ebro, 1944.

<sup>24</sup> Philip Gosse, *Histoire de la Piraterie*, nouvelle edition, Paris: Payot, 1952, f. 57; "Le premier grand pirate barbaresque indépendant fut Mourad. Il était, lui aussi, né chrétien de parents albanais". Roger Coindreau, *Les corsaires de Sale*, Paris: Institut des Hautes Etudes Marocaines, 1948, f. 25.

<sup>25</sup> Ph. Gosse, *Histoire de la Piraterie...*, f. 58; Alonso Castillo Solórzano, *Tiempo de regocijo y Carnestolendas de Madrid*, Madrid, 1627, fl. 164v.

<sup>26</sup> Diego de Haedo, *Topographia e Historia General de Argel, repartida en cinco tratados, do se veran casos estraños, muertes espantosas, y tormentos exquisitos, que conuine se entienden en la Christiandad: con mucha doctrina y elegancia curiosa*, Valladolid, 1612, fl. 84v, thotë se ishte shqiptar, "de nación que nosotros llamamos albanés". Edhe në një relacion mbi korsarët të Algjerit, Murat Reisi përmendet si shqiptar krahas Muhamet Shqiptarit : «Arnaut Mami, capitán de la mar de Argel y cabeza de los cossarios, renegado esclavón de los Arnautes... Morat Arráez, que dicen el Grande, renegado esclavón, Arnaut". British Museum, *Add.* 28.366. fl. 148; Miguel Herrero García, "Morato arráez", *Revista de Filología Española*, (Madrid, 1926), f. 181-182. Më 1588 nga 35 galerat që ndodheshin në Algjer "were commanded by eleven Turks and twenty-four renegades, including nations of France, Venice, Genoa, Sicily, Naples, Spain, Greece, Calabria, Corsica, Albania, and Hungary, and a Jew".

kalabrezit Uluxh Ali, detar i vjetër dhe i njohur në Algjer. Ndërsa në vitin 1578 kishte mundur të zotëronte si pronë personale një flotilje të përbërë prej disa galeonësh. Bëma më e rëndësishme e këtij viti ishte kur sulmoi dhe mori galerën *Santangel*, në të cilën udhëtonte për në Spanjë Duka i Terranovas, ish zëvendës-mbret dhe kapiten i përgjithshëm i Siçilisë. Murat Shqiptari vazhdoi lundrimet, i mbrojtur dhe i mbështetur nga miku i tij, detari dhe diplomati i madh shqiptari, Muhamet Arnauti.

Pikërisht më 1585, Murat Raisi realizoi lundrimin më të famshëm të jetës, duke arritur të bëjë atë që asnjë detar tjetër mysliman, qoftë maroken qoftë osman nuk e kishte bërë më parë: kalimin e ngushticës së Gjibraltarit dhe realizimin e inkursioneve në oqeanin Atlantik.<sup>27</sup> Deri atëherë detarët osmanë lundronin në afërsi të brigjeve, përveç rasteve kur u duhej të kryqëzonin Mesdheun. Skuadrilja e Murat shqiptarit kaloi ngushticën e Gjibraltarit dhe lundroi duke përshkuar gjithë atë distancë që i duhej për të mbërritur në ishujt Kanarie, një hapësirë kjo po aq e panjohur për osmanët sa ç'ishte një shekull më herët për europianët. Murati kishte marrë me vete një detar nga Kanariet që thoshte se e njihnte itinerarin, por kur mbas shumë ditësh lundrim të mundimshëm me rrema, piloti kanarien e humbi orientimin, i deklaroi Muratit se kishte frikë se mos ishin shmangur dhe i kishin kaluar Kanariet. Përgjigjja e Muratit i habiti të gjithë: «edhe pse nuk kam qenë kurrë, e kam të sigurtë se ajo që thua është e pamundur. Prandaj, vazhdo në këtë drejtim».<sup>28</sup> Murati kishte të drejtë.

---

Stanley Lane-Poole, *The Story of the Barbary Corsairs*, London: T. Fisher Unwin, 1890, f. 201-202.

<sup>27</sup> Kronika e El Mensurit, Sulltanit të Marokut, shkruar nga Antonio de Saldanha, flet për inkursionin e Murat Raisit në ishujt Kanarie. Mësojmë se mbas pesë muajsh lundrimi ishte kthyer në Algjer duke lundruar pjesën më të madhe të kësaj kohe në Oqeanin Atlantik. Saldanha pohon se Murat Shqiptari ishte detari i parë mysliman që kreu një ekspeditë të tillë në Oqeanin Atlantik. "atravessou a Argel depois de cinco meses de navegação, que não é pouco pera galés andando o mais do tempo no mar aceano (ainda que na costa de Berberia), e porventura foi ele o primeiro mouro que o intentou. *Crónica de Almançor, Sultão de Marrocos (1578-1603), de António de Saldanha*. Estudo crítico, introdução e notas por António Dias Farinha, Instituto de Investigação Científica Tropical, Lisboa 1997. fl. 66r; f. 187; *CSP*, Venice, vol. 8, nr. 406, f. 202, 9 shtator 1585. Një letër e ambasadorit venedikas në Spanjë bën me dije se Murati kishte shkuar me 7 anije.

<sup>28</sup> Haedo, *Topographia e Historia General de Argel*, fl. 90. "le dixo el piloto que dudava no huuesen passado muy adelante y errado el biaje, pero el Morato le respondio que no era posible, y siguiendo adelante descubrieron tierra en la Isla del Lançaloto".

Ky episod e bën të qartë se Murati kishte dijeni hartografike e gjeografike të sakta rreth brigjeve të Afrikës dhe oqeanit Atlantik. Kjo edhe për faktin se vepra e detarit osman Piri Reis, *Kitab-i Behriye*, e shkruar më 1526 dhe që mbështetet në harta origjinale të Kolombit mbi konfiguracionin e Atlantikut dhe të territoreve të sapozbuluara të Amerikës është një dëshmi monumentale e informacionit gjeografik që dispononin osmanët.<sup>29</sup>

Ekspedita e kapiten Murat Raisit ishte një ndër ndërmarrjet më të guximshme në historinë e detarisë, mbasi ky lundrim atlantik u krye me anije që ishin të destinuara për lundrimin në Mesdhe, por jo në oqean<sup>30</sup>. Dallimi thelbësor mes të dy zonave është se në Mesdhe përdorshin anijet me rrema, ndërsa në oqean rremat ishin të pafuqishëm për të përballuar dallgët dhe erërat e forta, prandaj përdorshin anije me vela.<sup>31</sup> Në vitin 1587, Murat Raisi ndërmerr sërish një inkursion drejt ishujve Kanarie në krye të 18 galeotave. Simbas burimeve bashkëkohëse ky inkursion ishte realizuar në marrëveshje me mbretëreshën e Anglisë që në të njëjtën kohë kishte dërguar edhe të famshmin Francis Drake që të sulmonte pozitat spanjolle në zonën e Gjibraltarit<sup>32</sup>.

<sup>29</sup> Svat Soucek, "Piri Reis and Ottoman Discovery of the Great Discoveries", *Studia Islamica*, 1964, f. 134; the Ottomans were aware of and interested in the discovery of the New World, marked on Piri's map as "Vilayet Antilia". Abbas Hamdani, "Ottoman Response to the Discovery of America and the New Route to India", *Journal of the American Oriental Society*, 101, 1981, f. 327-329; Rreth pasqyrimin të tokave shqiptare në këtë libër shih: Selami Pulaha, "Bregdeti i Shqipërisë në fillim të shek. XVI sipas Libër-udhëtimit të admiralit Osman Piri-Reis", *Studime Historike*, 3, 1981.

<sup>30</sup> B. Fisher, *Barbary Legend*, f. 129, pohon, "any of the Barbarossas ever entered the Atlantic".

<sup>31</sup> Ardian Muhaj, "Ottoman Corsairs in the Atlantic in the 16<sup>th</sup> Century. Murat Rais the Albanian and the First Ottoman Expedition to the Canary Islands", në *Uluslararası Piri Reis ve Türk Denizcilik Tarihi Sempozyumu: 26-29 Eylül 2013 / İstanbul*, Ankara: Turk Tarih Kurumu, 2014, vëll. III, f. 261-270.

<sup>32</sup> Letër e Hieronimo Lippomano, ambasador i Venedikut në Spanjë drejtuar Senatit. "Murad Reisi është nisur me 18 anije drejt Kanarieve ashtu siç bëri edhe para një viti dhe disa hamendësojnë se ai po vepron në marrëveshje me Mbretëreshën e Anglisë për të sulmuar Mbretin [e Spanjës]... Ata [spanjollët] kanë mësuar nga pesë robër anglezë të kapur në Kadis se [Francis] Drake ka synime të mëdha kundër mbretit të Spanjës. ... Ai ka marrë lejen [e korsarisë] nga Mbretëresha dhe është nisur me pesë anije drejt Indive dhe mbëriti në ngushticën e Magelanit ku mori një anije të ngarkuar me ar. I pakënaqur me këtë ai u kthye edhe një herë dhe tani është duke bërë kaq shumë dëme në Spanjë." 9 Maj 1587. *CSP Venice*, Vol. 8: 1581-1591 (1894), f. 269-283; Letër e Pedro de Ribera, nga Algjeri. Njofton për nisjen e Murat Shqiptarit. Disa thonë se

Murat Reisi ishte pajtuar me anglezët që dy vite më parë kur ndodhej në Vlorë dhe bashkëpunonte ngushtë në Atlantik.<sup>33</sup> Dy vjet më vonë, më 1589 ai bashkëpunoi edhe me francezët, gjithnjë në dëm të spanjollëve.<sup>34</sup> Këtë bashkëpunim me anglezët e francezët duket se e mbajti të pandërprerë edhe në vitet e mëvonshme. Madje, në sytë e tyre ai gëzonte një respekt të veçantë. Kjo vihet re edhe nga fakti se në fillim të vitit 1607 kur ambasadori francez De Breves e takon pak para nisjes për në More, ku do merrte postin e sanxhakbeut, me të ishte një pirat anglez i cili i uth dorën me respekt Murat shqiptarit.<sup>35</sup>

Figura e tij ka qenë një nga personazhet më të spikatura të letërsisë spanjolle të “shekullit të artë”. Krahas personazhit të Skënderbeut në

---

është nisur drejt arkipelagut të Kanaries në Oqeanin Atlantik. 5 prill 1587. «ha salido Morato Arráez con siete baxeles gruessos... Otros dicen que hirá a las islas de Canaria» British Museum, *Add.* 28.373. fl. 16; García, “Morato Arráez”, f. 181.

<sup>33</sup> *CSP. Venice*, vëll. 8, nr. 516, f. 276-277, 21 maj 1587. Letër e Hieronimo Lippomanos, ambasador i Venedikut në Spanjë drejtuar Doxhës dhe Senatit: “Kemi marrë vesh se rreth 100 anije, të ndara në disa skuadrilje janë nisur. Ato janë kryesisht angleze dhe pak bretone. Një nip i Drake, në krye të 25 anijeve është në Ngushticën e Gjibraltarit, duke u zënë pusi anijeve që po sjellin trupa nga Sicilia dhe të cilat sapo kanë mbërritur në Kartagenë me qëllim për të shkuar drejt Lisbonës. U është dërguar urdhër që të qëndrojnë në ndonjë port. Anije të tjera armike [angleze] janë në afërsi të Kepit të São Vicente dhe nuk lejojnë asnjë anije të kalojë pa hipur në bord me qëllim për të marrë informacione rreth flotës spanjolle me synimin për të grumbulluar forcat kundër saj. Ata thonë se Murat reisi është bashkuar me Drake. Këto lajme kanë detyruar mbretin të urdhërojë Markezsin e Snata Kruzit të dalë në det dhe të bashkojë forcat sa më parë me anijet e Biskajës; por kjo nuk mund të ndodhë përpara fundit të muajit. Ndërkohë anglezët janë zotër të detit dhe e kontrollojnë sic ua do qejfi. Lisbona dhe i kregjt bregdeti janë si edhe më parë të bllokuara...”.

<sup>34</sup> *CSP. Venice*, vëll. 8, 12 qershor 1589, nr. 846, f. 450. Hieronimo Lippomano nga Barcelona ku kishte mbetur i bllokuar për shkak të pranisë së 22 anijeve të guvernatorit të Algjerit dhe 12 të Murat Reisit. “Mbreti i Frances akuzohet se ia ka sugjeruar mbretin të Algjerit këtë operacion me qëllim për ta shqetësuar mbretin e Spanjës”.

<sup>35</sup> “Ce pendant que nous estions là, le Pirate Anglois, dont i’ay parlé cy-dessus, estant venu baiser les mains à Murat Rais ; comme il luy eut demandé puorquoy il prenoit les vaisseux François, amis des Musulmans, il luy respondit en Italien baragouiné, que les gens de sa qualité, n’auoient point esgard à ces alliances». *Relation des voyages de monsieur de Breues...*, f. 324. Në nëntor 1611 në Vlorë mbërrin një anije nga Berberia me 100 veta në bord, 40 prej të cilëve ishi anglezë dhe francezë. Pa kaluar një javë, kjo anije i zuri pritë afër Sazanit një anijeje nga Korcula, e kapi dhe e çoi në portin e Vlorës. Tenenti, *Piracy and the Decline of Venice...*, f. 81-82.

letërsinë spanjolle të shek. XVI-XVII gjetën jehonë edhe këta dy detarët e famshëm shqiptarë.<sup>36</sup>

Në literaturën spanjolle kapidan Murati i Madh, del për herë të parë më 1599, në veprën e Lope De Vegas, *Festime në Denia*.<sup>37</sup> Po ky autor në veprën *La Dorotea* e shquan Murat Raisin në mesin e katër detarëve më të famshëm.<sup>38</sup> Ndërsa në veprën *Shtegtari në dheun e vet*, më 1604 ai e paraqet Murat shqiptarin si një emër aq i njohur në brigjet spanjolle sa që atij mund t'i atribuoheshin me të vërtetë të gjitha llojet e piraterisë.<sup>39</sup> Po kështu ai del edhe në komeditë *Fitorja tjetër e markezit të Santa Kruzit*,<sup>40</sup> *Martesa e zbuluar*,<sup>41</sup> edhe *Robërit e Algjerit*.<sup>42</sup> Gjithashtu edhe Servantesi e përmend në dy prej komedive të tija, të botuara më 1615, me titull *Sulltana e madhe Zonja Catalina e Oviedos*<sup>43</sup> *Hamamet e Algjerit*.<sup>44</sup> Vicente Espinel, një tjetër autor spanjoll i kësaj kohe e përmend këtë

<sup>36</sup> Kronika e Barletit u botua në Lisbonë, me titull *Chronica do valeroso principe & inuenciuel Capitão Iorge Castrioto Senhor dos Epirenses ou Albaneses, que por suas maravilhosas obras foy chamado Scanderbego, que antre os Turcos quer dizer Alexandre Senhor*, escrita em Latim por Marino Barlecio Scutarino, & tresladada em Portugues por Francisco Dandrade. Dirigida ao muy alto & inuictissimo Rey de Portugal, dom Sebastião. Lisboa, em casa de Marcos Borges. Anno de 1567. Ështëbotuar në spanjisht po në Lisbonë më 1588: *Chronica del esforçado principe y capitan Iorge Castriota rey de Epiro o Albania*. Traduzida del lenguaje Portugues enel Castellano por Iuan Ochoa de la Salde, por Marino Barlezio, en Lisboa, 1588; Ndërsa rreth figurës së Skënderbeut në letërsinë spanjolle shih: Anila Lani (Bitri), "Figura e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut në teatrin spanjoll të shekullit XVII", *Studime filologjike*, nr. 3-4, 2002, f. 163-177.

<sup>37</sup> Lope de Vega, *Fiestas de Denia*, kap. II, Valencia, 1599, fl. 59-61.

<sup>38</sup> Lope de Vega, *La Dracontea*, kap. I, edic. Sancha, vëll. III, f. 189.

<sup>39</sup> Lope de Vega, *El Peregrino en su patria*, Impreso en Sevilla, por Clemente Hidalgo, 1604, fl.8v.

<sup>40</sup> Lope de Vega, *La nueva victoria del marqués de Santa Cruz*, ed. Real Academia, vëll. XIII, f. 47.

<sup>41</sup> Lope de Vega, *El desposorio encubierto*, Madrid, por la viuda de Alonso Martin, 1620, f. 226.

<sup>42</sup> *Obras de Lope de Vega*, Real Academia, nueva edicion, vëll. IV, *Los cautivos de Argel*, jornada III, f. 259.

<sup>43</sup> *Comedia famosa de la gran sultana Doña catalina de Oviedo*, jornada I, në *Ocho comedias, y ocho entremeses nuevos nunca representados, compuestos por Miguel de Cervantes Saavedra*, dirgidas a don Pedro Fernandez de Castro, en Madrid, por la viuda de Alonso Martin, 1615, fl. 132.

<sup>44</sup> M. Cervantes, *Comedia famosa de los baños de Argel*, jornada I, Madrid, 1615, po aty, fl. 60v.

personazh në romanin *Jeta e Markut të Obregonit*, botuar më 1618.<sup>45</sup> Ndërsa shkrimtari Castillo Solorzano në një novelë, të botuar më 1631 na jep një tjetër fragment interesant.<sup>46</sup> Mirëpo komentuesit e veprave letrare të cituara më sipër, kanë qenë në mëdyshje në se bëhet fjalë për një pirat real apo imagjinar.<sup>47</sup>

Në vitin 1595 arrin të bëhet kryeadmiral i Algjerit dhe çdo pranverë pasi ia ngarkonte të gjitha detyrat zyrtare një zëvendësi, ai nisej për të lundruar. Duket se karriera e tij mbas fushatave në Atlantik dhe mbas detyrës së kryeadmiralitetit të Algjerit i ngjason një pelegrinazhi drejt vendlindjes së vet, Shqipërisë. Nga të dhënat historike rezulton se mbas Algjerit, qe dërguar nga Porta e Lartë në Tuniz, ku në vitet 1603-1607 e gjejmë aty si admiral apo bejlerbe.<sup>48</sup> Në vitin 1606 apo më 1607 ai emërohet bejlerbe i Moresë.<sup>49</sup> Pak para nisjes së tij drejt Modonit të Moresë për të marrë detyrën e sanxhakbeut, tashmë në moshën 80 vjeçare, ambasadori francez në Stamboll, De Breves e takon në bordin e anijes së tij, duke na dhënë një përshkrim shumë interesant.<sup>50</sup> Kjo duket

<sup>45</sup> Vicente Espinel, *Relaciones de la vida del escudero Marcos de Obregon*, Madrid : por Iuan de la Cuesta, 1618, f. 26.

<sup>46</sup> Alonso Castillo Solórzano, *Noches de placer: en que contiene doze nouelas*, por don Alonso de Castillo Solorzano, en Barcelona, por Sebastian de Cormellos, 1631, fl. 116v.

<sup>47</sup> Më gjerësisht: Ardian Muhaj, “Personazhe në letërsinë spanjolle të shekullit të artë: mes realitetit historik dhe letrar arbëror”, *Vjetari. Arkivi i Kosovës*, 2007, f.

<sup>48</sup> Lejekalim lëshuar nga Murat Raisi dy prej robërve të tij Gio Batta e Giacomo Corsi të liruar. Letra u drejtohet të gjithë kapidanëve muslimanë që të mos i trazojnë dhe t’ua mundësojnë kthimin në shtëpitë e tyre. 6 shtator 1604. Archivio di Stato di Genova, *Riscatto dei Cattivi*, Jean Pignon, “Gênes et Tabarca au XVII<sup>e</sup> éme siècle”, *Les Cahiers de Tunisie. Revue de sciences humaines*, 109-110, Tunis, 1979, dok. nr. 67, f. 82-83.

<sup>49</sup> İdris Bostan, *Adriyatik'te korsanlık. Osmanlılar, Uskoklar, Venedikler. 1575-1620*, Istanbul: Timaş yayınları, 2009, f. 51-54 dhe f. 71, shën. 88, jep si datë të emërimit të tij në këtë post shkurt 1607, megjithëse akoma nuk kishte mbërritur në More; Për aktivitetin e tij në Egje gjatë kohës që ndodhej në këtë post shih: Mikail Acıpinar, “Osmanli kronikleri işığında kaptan-i derya Halil Paşa'nin akdeniz seferleri (1609-1623)”, *Tarih İncelemeleri Dergisi*, 28 / 1, Izmir, 2013, f. 8, 10-11. Autori megjithatë mendon se Murat Reisi ishte nga Rodosi ku edhe u varros. Duket se xhamia dhe tyrbja e tij që edhe sot përbëjnë një atraksion turistik në Rodos janë përkujtim i kontributit të tij si sanxhakbe i Moresë. Kjo nuk i bie ndesh faktit se ai ishte shqiptar dhe që vdiq në Vlorë. Dihet se më 1609 u plagos rëndë siç ishte plagosur edhe herë të tjera në betejë.

<sup>50</sup> De Breves shkon nga Tunizi në Goletë për të takuar Muratin i cili pikërisht në atë kohë bëhej gati për t’u nisur drejt detyrës së tij të re si sanxhakbe i Moresë. Edhe guvernatori i Tunizit Osman Day në emër të përfaqësuesve më të lartë të ushtrisë

se e vërteton dëshminë e anglezit Knight që e raporton vdekjen e tij në Vlorë, në moshën 104 vjeçare, më 1638.<sup>51</sup> Në të vërtetë lidhjet e tij me atdheun e vet i kishte mbajtur të pashkëputura gjatë gjithë kohës edhe pse jeta e trazuar prej detari e kishte përplasur në brigjet e shumta të Mesdheut e të Atlantikut. Më 1569 atë e gjemë në Durrës.<sup>52</sup> Në pranverë të vitit 1585 dëshmohet në Vlorë ku ambasadori anglez dhe ai francez kërkuan nga Porta e Lartë ndëshkimin e tij për dëmet që u kishte shkaktuar.<sup>53</sup> Ndërsa në vitin 1591 e gjemë në Adriatik ku mes tjerash

kërkonte që rreth kërkesave të ambasadorit francez të konsultohej me Muratin, madje duke u zotuar se do bënte ashtu si do thoshte Murat Shqiptari. “de faire ce qu’il approuveroit”. Më tej De Breves pohon “Ce Murat Rais est un vieil corsaire Turc, des plus renommés de ce siècle, en ayant exercé le mestier durant soixante ans, avec tres-grande prospérité, se pouvant vanter avec verité, d’auoir pris de galeres de tous les Estats de Chrestienté, sans que iamais on l’ayt sceu accrocher. Il est agé de quatre-vingts ans, petit homme, fort bourgeonné au visage braue & courageux au possible. Nous le trouuâmes à la pope de son vaisseau, non comme les autres Capitaines Turcs, pompeusement vestu, sous vne tente de damas, ny entouré de iunes garçons couuerst de soye & drap d’or & enuolopez de precieuses fourreures: mais enuironné d’vne troupe de vieux Corsaires...: lui vestu comme vn simple villageois, d’vne casaque de drap blanc..., mais la chiorme estoit bien gaillarde & en bon point, & la soldatesque toute braue, robuste & bien deliberée.» Ai e priti ambasadorin De Breves “fort humainement, & lui promit de n’espargner aucune persuasion, pour remettre les Ianissaires de Tunis en leur deuoir”. François Savary de Brèves, *Relation des voyages de monsieur de Breues tant en Grèce, Terre-Sainte et Aegypte qu’aux royaumes de Tunis et Arger: ensemble, un traité faict l’an 1604 entre le roy Henri le Grand et l’empereur des Turcs et trois discours des moyens et advis pour aneantir l’Empire des Turcs*. Paris: Chez Nicolas Gasse, 1628, f. 323-324; Shih edhe Jean Pignon, “Les relations franco-tunisiennes au debut du XVII<sup>e</sup> siècle: l’accord de 1606”, *Les Cahiers de Tunisie. Revue de sciences humaines*, 26/101-102 (1978), f. 169-170.

<sup>51</sup> Knight witnessed the end at Valona in 1638 of ‘Murate a renegade of the Corsica [lexo: korsar] nation, a person of great honour in Algiers, lieutenant general of the armada... a man of 104 years of age’ Thomas Osborne, *A Collection of Voyages and Travels, consisting of authentic writers in our own tongue, which have not before been collected in English, or have only been abridged in other collections. And continued with others of note, that have published histories, voyages, travels, journals or discoveries in other nations and languages, relating to any part of the continent of Asia, Africa, America, Europe, or the islands thereof, from the earliest account to the present time...* 1745, vol. II, f. 477.

<sup>52</sup> Klemen Pust, “Beneško-osmanski pomorski spopadi na Jadranu v 16. Stoletju”, *Povijesni prilozi* 38, Zagreb, 2010, f. 118.

<sup>53</sup> *CSP. Venice*, vëll. 8, London: Her Majesty’s Stationery Office, 1894. 26 shkurt 1585, nr. 258, f. 107. Ambasador i Venedikut në Stamboll, drejtuar Senatit dhe gjithashtu, 29 mars 1585, nr. 267, f. 113-114.

merr një anije në afërsi të Splitit me mallra e para të vlerësura në 15 mijë dukatë.<sup>54</sup>

Për Muhamet Shqiptarin të cilin më së shumti e përmend Servantesi, ka ekzistuar një tis mjegullsie e mungese informacioni jo vetëm si personazh letrar por para së gjithash si figurë historike. Megjithatë ai ka ekzistuar jo vetëm në veprën servantesiane por edhe në realitetin historik të kohës. Muhamet Shqiptari (Memi Arnauti), ishte një figurë e shquar jo vetëm si detar, por edhe si diplomat e burrë shteti.<sup>55</sup> Ai mbante korrespondencë të rregullt me shtetarët europianë të kohës, duke shkëmbyer dhurata të ndryshme, siç është rasti i Medicëve të Firences.<sup>56</sup> Mbi cilësitë e këtij kapitani të shquar shqiptar na ka lënë një dëshmi të

<sup>54</sup> Letër e Sulltan Muratit III drejtuar bejlerbeut të Algjerit, ku thuhet se Bailiu venedikas ishte ankuar se Murad Reis, kishte marr në Adriatik një anije nga Spliti me 15 mijë dukatë, në para e mallra, një anije nga Perasti, një barkë nga Kotorri dhe një fregatë nga Budva. ASV, *LST, busta 8*, 1591; Maria P. Pedani Fabris, *I "Documenti turchi" dell'Archivio di Stato di Venezia*, Roma: Istituto Poligrafico e Zecca dello Stato, 1994, dok. 1018, f. 258; K Pust, "Beneško-osmanski pomorski spopadi... ", f. 117-118.

<sup>55</sup> "ishte ky mbret në kohën kur u largua nga Algjeri dyzet vjeç, me trup të gjatë, mjekërzi, shumë i dashur me të gjithë dhe aspak i urreyer nga të krishterët". Haedo, *Topographia e Historia General de Argel*, fl. 90r-90v.

<sup>56</sup> Muhamed Shqiptari i dërgon Dukës së Madh Francesco I Medici disa dhurata ekzotike, si dy kuaj, dy luanë, një struc, etj. Mësojmë po ashtu se Muhamed Shqiptari kishte një kancelar italian që shkruante korrespondencën e tij në italisht.«[...] Et per non havermi al presente corso altro che mandar a Sua Altezza Serenissima per Giacobbo Brangia scrivano del nostro capitano Arnaot Memi bei, mando Geronimo Salvino polsano et Sebastiano de Paula pisano sudditi di Sua Altezza Serenissima con doi cavalli et doi leoni et uno struzzo parimenti uno paro di coltelli con doi mandili piccoli indoratti et doi marrama [...]». *Archivio di Stato di Firenze* [më tej: *ASF Mediceo del Principato*, busta 4279, fl. 36, 20 tetor 1586. Nga ana e tij Francesco I de' Medici i dërgon Muhamed Shqiptarit dhurata të ndryshme mes të cilave katër xhaketa luksoze: "[...] è tanto il desiderio ch'io tengo di corrispondere a quella buona volontà che ho scorto in lei verso di me, et all'amorevolezza che me dimostra ogni giorno... desiderando io compiacere a lei et alla Signora sua consorte [Sayma Mami] in tutto quello che io posso. Et di più gli ho consegnato una cassetta dentrovi quattro giubbe, dua di tela d'oro, et dua di dommaschi di quelle che si fanno in questa città... insegno dell'affettione che le porto, et del desiderio che haverò sempre di farle ogni servitio. [...]". *ASF, po aty*, busta 270, fl. 39. 1 shkurt 1587. Tri vite më vonë kur Francesco I Medici vdes dhe në vend të tij vjen Ferdinando I Medici, Muhamed Shqiptari në shenjë dëshirë për të vazhduar miqësinë tradicionale i dërgon edhe dukës së ri si dhuratë një kalë. "[...] Per segno di confirmatione de la buona amicitia ho hautto con la felice memoria del defuncto Grand Duca suo fratello la qual desidero perpetuar con Sua Altezza li mando uno cavallo[...]". *ASF, po aty*, busta 4279, fl. 46, 9 tetor 1589.

vyeshme një ambasador i mbretit të Marokut, Ebul Hasan Tamgruti. Ky i fundit pat qenë dërguar nga mbreti i Marokut Ahmed el Mensur me mision diplomatik për në Stamboll, tek Sulltan Murati III.<sup>57</sup> Diplomatët marokenë nisen nga Fesi për në portin maroken të Tetuanit në pritje të anijes që do t'i çonte në Stamboll. Aty mbërrin një anije nga Algjeri «e komanduar nga një kapitan i quajtur Arnaut Mami» që do të duhej të merrte në bord përfaqësuesit osmanë që ktheheshin nga Maroku dhe delegacionin maroken. Reisi Memi Arnauti ishte padyshim një detar i shkëlqyer dhe njohës i përsosur i kushteve të udhëtimit në Mesdhe. Tamgruti lë të kuptohet se Kapitani kishte një përvojë të tillë në udhëtimin në Mesdhe, sa që i njihte në mënyrë të përsosur distancat e udhëtimit në det dhe relievin e brigjeve. Kur po kalonin mes për mes Mesdheut nga Tripoli drejt bregut të Moresë, për shumë kohë humbën kontaktin me tokën dhe Tamgruti shpjegon: «Kapitani kishte shpresuar që ta shquante në mëngjesin e kësaj dite dhe mbasi nuk ndodhi (kështu), ai filloi të bëhej nervoz... Urdhëroi marinarët dhe shërbëtorët që e kishin shikimin më të qartë që të ngjiteshin lart dhe të vëzhgonin, që të mund të shquanin tokën. Ishte një i krishterë që e dalloi tokën që prej lart.... Ai i bëri një dhuratë atij që e kishte shquar i pari tokën».<sup>58</sup>

Një episod i veçantë i jetës së tij është ai i kapjes rob të shkrimtarit të shquar spanjoll dhe ndër më të famshmit në botë Miguel Servantes. Muhamet Shqiptarin e përmend Servantesi në mjaft raste si personazh letrar, por dihet se shkrimtari i shquar spanjoll e kishte njohur edhe personalisht shqiptarin e madh. Servantesi kishte marrë pjesë në betejën e famshme të Lepantit ndërmjet flotës osmane dhe flotës së koalicionit të

<sup>57</sup>*En-Nafhat el Miskija fi-s-sifarat et Tourkiya, Relation d'une ambassade marocaine en Turquie (1589-1591)*, par Abou-l- Hasan Ali Ben Mohammed et- Tamgrouti, ed. Henry de Castries, Paris: Paul Geuthner, 1929, f. 9-81. Itinerari i ndjekur nga Muhamed Shqiptari fillonte nga porti maroken i Tetuanit nga ku niset më 3 gusht 1589; Targa, në afërsi të Velezit dhe Meliljes; ishujt Zaffarines, Honein, afër Oranit, Cherchell dhe më 23 gusht mbërrijnë në Algjer, prej ku nisen më 1 shtator. Më pas Dellys, Bugie dhe mbas një shtrëngate të vështirë në Collo, Bona, Bizerta, Ghar el-Melh (Porto Farina), dhe Goleta për të mbërritur në Tuniz. Më pas Suza dhe Monastir, Mehdija, Sfaks, ishulli i Xherbas dhe mbërrijnë në Tripoli më 6 tetor ku qëndrojnë deri më 8 nëntor. Nga Tripoli kryqëzojnë Mesdheun dhe mbërrijnë në bregun verior të këtij deti në portin e Koronit, më pas Monemvasia dhe Eube, prej aty në Kio dhe më pas në ishullin e Tenedos në hyrje të Dardaneleve dhe më pas Galipoli, dhe më 25 nëntor mbërrijnë në Stamboll.

<sup>58</sup> Tamgrouti, *En-Nafhat el Miskija*, f. 41-42.

fuqive europiane. Në këtë betejë, Servantesi pasi humbi dorën e majtë, mbeti në Mesina të Italisë për të shëruar plagën. Ndërsa më 26 shtator 1575, ai u nis nga Napoli me anijen e mbretit «Dielli-El Sol» për t'u kthyer në Spanjë së bashku me të vëllanë Rodrigo. Kjo anije, u kap në det nga i famshmi Memi Arnaut, detari më i njohur i kohës së tij.<sup>59</sup> Edhe Luis de Góngora e përdor si figurë letrare shqiptarin e madh.<sup>60</sup> Kulmi i karrirerës së këtij kapitanit të shquar mbërrin kur ia del të zgjidhet «mbret» i Algjerit, ose më saktë kryetar i regjencës së Algjerit. Në vitet 1577-1580 në krye të regjencës ndodhej veneciani Hasan Pasha, i cili qeveris më dorë të hekurt, duke bërë shumë kundërshtarë, çka shkakton një revoltë e cila solli në krye të regjencës hungarezin Xhaferr Pasha. Ky ishte zëvendësuar nëpërmjet një komploti nga kadiu Ramadan, mirëpo ky i fundit në kohën kur ndodhej në një mision për t'u rikthyer dy anije francezëve me urdhër të Portës së Lartë, Taifa ose Lidhja e kapidanëve përfitoi nga rasti për të zgjedhur dhe për të sjellë në pushtet shefin e vet dhe detarin më të shquar të kohës: Memi Arnautin.<sup>61</sup> Reputacioni i tij ishte i tillë sa që në vitin 1574 tre bejlerbej i kërkuan Portës së Lartë që ai të caktohej sanxhakbe. Kjo kërkesë u plotësua me emërimin e tij si sanxhakbe i Mizistres dhe Naksosit.<sup>62</sup> Ashtu sikurse dhe miku i tij shqiptari Murat Reisi edhe ai i mbante lidhjet me vendlindjen.<sup>63</sup> Kështu

<sup>59</sup> *Don Kishoti*, pj, I, cap. 41; Ardian Muhaj, “Rreth pranisë së shqiptarëve në Mesdheun Perëndimor në shekujt XVI-XVII”, *Univers*, nr. 7, Tiranë: 2005, f. 198-212; Ky pohim i Servantesit duket se e vërteton atë që thotë Martin Fernandez de Navarrete, *Vida de Miguel de Cervantes Saavedra. Escrita e ilustrada con varias noticias y documentos ineditos pertenecientes a la historia y literatura de su tiempo*, Madrid: Real Academia Española, 1819, f. 356, që e kundërshton mendimin që ishte Muhamed Shqiptari ai që zuri rob Servantesin. Simbas tij fakti që Servantesi e përmend Muhamed Shqiptarin ka të bëjë me atë që ky ishte kapidan i skuadrës prej tre galeotash që zuri rob Servantesin dhe që Servantesi e njihte shumë mirë Muhamed Shqiptarin nga që ky ishte kryeadmiral i flotës së Algjerit, por jo në cilësinë e pronarit të tij. Simbas tij ishte fama e Muhamed Shqiptarit si kryekapidan i të gjithë detarëve të Algjerit dhe njohja me të që e bën Servantesin ta përmendë në novelat e tij.

<sup>60</sup> Robert Jammes, *Études sur l'oeuvre poétique de Don Luis de Góngora y Argote*, Bordeaux: Ferret, 1967, f. 383.

<sup>61</sup> Ch. André Julien, *Histoire de l'Afrique du Nord, Tunisie, Algérie, Maroc*, Paris: Payot: 1931, f. 537-538.

<sup>62</sup> E. S. Gürkan, “The centre and the frontier ...”, f. 146; I. Bostan, “Garp Ocaklarının”, f. 80, doc. XV.

<sup>63</sup> Emrah Safa Gürkan, “Fooling the Sultan: Information, Decision-Making and the “Mediterranean Faction” (1585-1587), *Osmanli Arastirmalari/ The Journal of Ottoman Studies*, 45 (Istanbul, 2015), f. 84, e konsideron Muhamed Shqiptarin si

simbas një agjenti spanjoll më 1580 Arnavud Memi ndodhej në Vlorë, prej ku i dërgon kryeadmiralit osman Uluxh Ali, një korrier napolitan si duket të zënë rob bashkë me një letër të shkruar nga komandantë të lartë spanjollë.<sup>64</sup> Në vitin 1586 (ai) sërish operonte në Adriatik nga portet shqiptare.<sup>65</sup> Ndërsa në vitin 1594 arrin të marrë një galerë venedikase ndërmjet Shebenikut e Splitit të komanduar nga Marino Gradenigo<sup>66</sup> dhe në një dokument nga Tunizi ai përmendet me titullin pasha.<sup>67</sup>

Në ekstremin tjetër, në oqeanin Indian dëshmohej gjithashtu kontributi i shqiptarëve në njohjen e popujve e viseve të Lindjes së Largët, pra në pasurimin e dijes dhe unifikimin e qytetërimit njerëzor.<sup>68</sup> Në vitin 1536, sulltani i Guzeratit, Bahadir Shah dërgon një delegacion në Stamboll për të kërkuar ndihmë kundër sulmeve të portugezëve. Në këto rrethana Sulltan Sulejmani I urdhëroi përgatitjen e një flote për ta dërguar në Indi. Komandën e kësaj fushate detare e merr guvernatori (bejlerbeu) i Egjiptit Sulejman Pasha që arrin të mbledhë një flotë prej 80 anijesh dhe një ushtri prej 20 mijë ushtarësh për të lundruar në ujrat e

eksponent i lartë i lobit mesdhetar apo “Mediterranean faction” siç e quan, në të cilin përfshiheshin kryesisht detarë dhe qeveritarë të posteve të larta kryesisht me origjinë shqiptare, italiane dhe europiane dhe që synonin që ta mbanin politikën osmane të përqendruar në zonën e Mesdheut dhe jo në Lindjen e Mesme apo në Europën Qendrore për ta sjellë investimin politik të shtetit osman më afër zonës së tyre të interesit.

<sup>64</sup> Kryeadmirali osman pastaj e dërgoi si korrierin e zënë rob edhe letrën tek kryeministri Mustafa Pasha. Archivio General de Simancas, SE, 1338, fol. 15. (30 qershor 1580).

<sup>65</sup> Alberto Tenenti, *Piracy and the Decline of Venice, 1580-1615*, London: Longmans, 1967 (bot. i parë. Bari: Laterza, 1961), f. 25, mendon se Muhamet Shqiptari ishte nip i mbretëreshës së Marokut, e cila ishte Zahra, vajza e Murat Reis shqiptarit. Në gusht të 1586 së bashku me Hasan Pashë Venecianin, secili me mbi 10 fusta sulmojnë anijet venedikase në Adritaik.

<sup>66</sup> *Po aty*, f. 26

<sup>67</sup> Del me emrin “ranauto bascia” në një dokument të 1 shtatorit 1594 që bën fjalë për një borxh që Antonio Tagliaferro, gjenovez, i kishte bashkëatdhetarit të tij gjenovez Xhaferr. «Ciafer genoese chiamato in christianesimo Zacana Vione do Santa Maria del Cervo... Questi scuti 70 desto ciafer have pagati nelle mani di Ranauto Bascia». Archivio di Stato di Genova, *Riscatto dei Cattivi*, Jean Pignon, “Gênes et Tabarca au XVII<sup>e</sup> éme siècle”, *Les Cahiers de Tunisie. Revue de sciences humaines*, 109-110, (1979), dok. nr. 1, f.36-37;

<sup>68</sup> Natyrisht ndërhyrja osmane në oqeanin Indian nuk ka pasur rëndësinë që ka pasur ajo në Mesdhe. Aldo Gallotta, “Ottomani e portoghesi nell’Oceano Indiano nel XVI secolo”, në Congresso Internazionale “Portogallo e i mari”: un incontro tra culture, bot. Maria Luisa Cusatti, Napoli: Liguori editore, 1997, f. 184.

Oqeanit Indian<sup>69</sup> Flota e udhëhequr prej tij zbarkoi në Kathi, në gadishullin e Guzeratit dhe pushtoi fortesat e Kukas dhe Kaçit. Synimi kryesor ishte fortesa e Diut, por nuk ia doli dot. Atëherë Sulejman Pasha e heq rrethimin nga Diu, të cilin e mbronte një komandant portugez i quajtur Antonio da Silveira.<sup>70</sup>

Sulejman Pasha ishte shqiptar dhe ka qenë edhe vali i Hixhazit, pra i Mekës dhe Medinës, deri sa arrin të bëhet edhe kryeministër i Perandorisë Osmane.<sup>71</sup> Falë masave efikase të ndërmarra nga Sulejman Pasha pozita strategjike e osmanëve në oqeanin Indian u forcua në mënyrë të dukshme.<sup>72</sup> Në kohën kur Sulejman Pasha u emërua kryeministër i shtetit osman politika e ndjekur prej tij, i kishte detyruar portugezët që të kërkojnë të merren vesh me osmanët rreth tregtisë së erëzave, në vend që të kundërshtojnë me forcë ekspansionin në Oqeanin Indian. Më 1540, portugezët i kishin propozuar Portës së Lartë që t'i furnizonin një sasi vjetore prej 2 500 deri në 3 000 kuintal erëzash dhe t'i shkarkonin në Basra. Porta e Lartë këmbënguli që kjo sasi të transportohej në anije osmane prej portit të pavarur të Kalkutës. Që në fillim të emërimit si qeveritar i Egjiptit u shqua për gjenialitetin dhe aftësinë e tij. Më 1532 ai projektoi me seriozitetin dhe kujdesin më të madh teknik hapjen e kanalit të Suezit që do të lidhte Mesdheun me Detin e Kuq, duke shfrytëzuar edhe rrjedhën e Nilit. Punimet duket se filluan por nuk u përfunduan për arsye të ndryshme.<sup>73</sup> Suksesi i tij në Detin e Kuq dhe oqeanin Indian u bë shkak kryesor i emërimit në postin e kryeministrit. Sulejman Pasha dinte të mblidhte rreth vetes njerëz të

<sup>69</sup> Giancarlo Casale, "The Ethnic Composition of Ottoman Ship Crews and the "Rumi Challenge" to Portuguese Identity", *Medieval Encounters* 13 (Brill, 2007), f. 128-129.

<sup>70</sup> Cemalettin Taşkiran, "Les relations ottomano-portugaises au XVI<sup>e</sup> siècle», në *XXIV Congresso International de História Militar*, Lisboa 24 a 29 de Agosto de 1998, Lisbonë 1999, f. 134.

<sup>71</sup> «shqiptar prej memalikëve të Sulltan Sulejmanit ( سليمان السلطان ممالیکین من الارنوت من هو )». Kutbud-din Muhammed bin Ahmed En Nehravali, *Kitabul Alam bil Alam Bejtullahi el Haram- Geschichte der Stadt Mekka und ihres Temples. Nach den Handschriften zu Berlin, Gotha und Leiden*, herausgegeben von Ferdinand Wüstenfeld, vëll. III, Leipzig, 1857, f. 300-301; Barros, *Quarta década da Ásia...*, kap. II, f. 636, e nxjerr si jeniçer nga Morea. "de nação grego ianiçaro, natural da Morea".

<sup>72</sup> Giancarlo Casale, "The Ottoman Administration of the Spice Trade in the Sixteenth-Century Red Sea and Persian Gulf", *Journal of the Economic and Social History of the Orient*, 49/ 2 (Brill, 2006), f. 173

<sup>73</sup> Salih Özbaran, *Umman'da kapışan İmparatoruklar. Osmanlı ve Portekiz. Emperyal ve kutsal, muhafız ve mültezim*. Istanbul: Tarihçi Kitabevi, 2013, f. 145.

aftë e me përvojë në lundrimin oqeanik. Baza mbështetëse e tij ishin këshilltarët dhe specialistët me origjinë italiane, të cilët kishin një interes të veçantë në kontrollin osman në tregtinë fitimprurëse të erëzave. Këta këshilltarë të afërt të tij përfshinin anëtarë me influencë të bashkësisë hebreje iberike si Abraham Castro, që mori drejtimin e doganës së Aleksandrisë me mbështetjen e Sulejman Pashës, dy venecianë të konvertuar në myslimanë Giovanni Contarini dhe Gian Francesco Giustiniani<sup>74</sup>, që vinin nga familje të njohura si edhe një rob portugez me përvojë në oqeanin Indian, Diego Martins. Këtë të fundit Giustiniani e Contarini e bindën të bëhej musliman dhe t'u bashkohej atyre në rrethin e ngushtë të këshilltarëve të Sulejman Pashës dhe në orientimin e politikës osmane drejt tregtisë së erëzave të oqeanit Indian.<sup>75</sup> Simbas burimeve portugeze edhe vetë kërkesa e Sulltanit të Guzeratit për të kërkuar ndihmën e Stambollit kundër portugezëve, kishte ardhur si pasojë e ndërhyrjes së një italiani të vendosur në Indi, Hoxha Sefer.<sup>76</sup> Ky po ashtu ishte edhe burimi kryesor i informacionit për Sulejman Pashën. Në njëfarë mënyre vetë fushata indiane e Sulejman Pashës ishte një përpjekje e sukseshme e lobit shqiptaro-italian në Egjipt për të marrë mbështetjen e

<sup>74</sup> Nga fundi i shek. XVI udhëtari veronez Filippo Pigafetta gjeti një numër të madh italianësh që punonin në bazën detare të Suezit duke përfshirë sanxhakbeun që ishte italian nga Pontremoli. "Vi sono anche parecchi rinnegati italiani col sangiacio, che è di Pontremoli, per il servizio delle galere." Pigafetta, "Il Golfo di Suez e il Mar Rosso," f. 305; Vladimir Mažuranić, "Melek Jaša Dubrovčanin u Indiji godine 1480-1528 i njegovi prethodnici u Islamu prije deset stoljeća", *Zbornik kralja Tomislava*, JAZU, Zagreb, 1925, bën fjalë për një raguzas që supozohet të ketë mbërritur në Indi në kërkim të tregtisë së erëzave që në shekullin e XV.

<sup>75</sup> G. Casale, "The Ottoman Administration of the Spice Trade", f. 174-175; Kronikat arabe e quajnë Sulejman Basha et-Tauashi er-Rumi, mbasi në zonën e Gjirit Persik dhe të Oqeanit Indian osmanët e ardhur nga Mesdheu nuk quheshin turq por *rumë*. R. B. Serjeant, *The Portuguese off the South Arabian Coast. Hadrami Chronicles. With Yemeni and European Accounts of Dutch Pirates off Mocha in the Seventeenth Century*, Oxford: Clarendon Press, 1963, f. 60-85.

<sup>76</sup> "E a razão porque se moveo a ir a aquelle lugar mais que a outro algum da India, foi por Coge Sofar muitas vezes ter escrito... que se a armada dos Turcos ouvesse de vir, viesse dereito a Dio". Barros, *Quarta década da Ásia...*, kap. III, f. 641. Gjithashtu është interesant pohimi i kronistit se kur Sulejman Pasha mbërrin në portin indian të Diut, askush nuk ia uroi mikpritjen, madjes as vetë udhëheqësit myslimanë të zonës, përveç italianit Hoxha Sefer. "Só Coge Sofar como homem criado entre eles, & que com elle tinha practica sobre sua vinda à India, foi à galè de Soleimão Baxia darlhe os parabens da sua chegada". *Po aty*, kap. VII, f. 653.

Portës së Lartë në synimin e tyre për të ndërhyrë në tregtinë fitimprurëse të erëzave që ishte në duart e portugezëve.<sup>77</sup>

Megjithëse përballja mes flotave detare osmane dhe portugeze në shek. XVI në oqeanin Indian zhvillohej larg teatrit të Mesdheut, në fakt të dy fuqitë detare ishin në pjesën e tyre më të madhe me origjinë mesdhetare.<sup>78</sup> Megjithëkëtë origjinë të përbashkët mesdhetare, detarët e secilës palë e shihnin veten në këndvështrime të ndryshme. Portugezët si pjesë e një kombësie të mbështetur në lidhjen e gjakut ndërsa osmanët si pjesë e një «perandorie» kozmopolite.<sup>79</sup> Duhet theksuar se çdo diskutim mbi identitetin etnik në kontekstin osman përballet me një problem të terminologjisë. Europianët e shek. XVI, ngjashëm me shumë autorë të sotëm zakonisht i quajnë osmanët si “turq”. Në fakt, ky term është përdorur nga europianët si një term përgjithësues për çdo mysliman të çfarëdo origjine etnike, madje vetë banorët e Evropës Perëndimore që konvertoheshin në myslimanë quheshin «turq».<sup>80</sup> Nga ana tjetër në Perandorinë Osmane këndvështrimi ishte tjetër. Termi «turk» si etnonim përdorej rrallë dhe si rregull përshkruante fiset nomade turqishtfolëse.<sup>81</sup> I mirëinformuar Diogo do Couto shpjegon qartë se ata që në Indi quheshin

<sup>77</sup> Kronisti portugez Barros, pohon se Sulejman Pasha kishte kërkuar me ngulm që ta ndëmernte ai këtë fushatë dhe se të gjitha shpenzimet do t'i mbulonte vetë, ngaqë ishte shumë i pasur dhe se nga Stambolli nuk kishte kërkuar asgjë tjetër përveç ushtarëve dhe artilerisë. “& se offereceo a fazer esta armada a sua propria custa, sem querer mais delle que a gente & artelharia.” Barros, *Quarta década da Ásia...*, kap. II, f. 636.

<sup>78</sup> S. Özbaran, *Umman'da kapışan İmparatoruklar. Osmanlı ve Portekiz...* f. 146-152; Dejanirah Couto, “No rasto de Hadim Suleimão Pacha: alguns aspectos do comércio do Mar Vermelho nos anos de 1538-1540”, në *A carreira da Índia e as Rotas dos estreitos*, ed. A.T. Matos dhe L. F. Thomaz, Angra do Heroísmo, 1998, f. 483-508; Giancarlo Casale, *The Ottoman Age of Exploration*, Oxford University Press, 2010; Salih Özbaran, *The Ottoman Response to European Expansion*, Istanbul, 1994; Salih Özbaran, *Ottoman Expansion towards the Indian Ocean in the Sixteenth Century*, Istanbul: Bilgi Üniversitesi, 2009.

<sup>79</sup> G. Casale, “The Ethnic Composition of Ottoman Ship Crews...”, f. 122-123.

<sup>80</sup> Si në shprehjen anglisht “to turn Turk,” me kuptimin “to convert to Islam”. E ilustron këtë më së miri tragjedia e autorit anglez Robert Daborne, *A Christian turn'd Turk. Or the Tragical Lives and Deaths of the Two Famous Pirates, Ward and Dansiker*, London, 1612; Për rastin shqiptar shih: Pëllumb Xhufi, “Turq që luftojnë kundër turqve”, *Studime historike*, nr. 3-4, 2014, f. 31-43.

<sup>81</sup> G. Casale, “The Ethnic Composition of Ottoman Ship Crews...”, f. 124.

“rumë” ishin në fakt ballkanas dhe jo turq nga “Turkistani”, dhe kishin të drejta të barabarta qofshin hebrenj, të krishterë apo myslimanë.<sup>82</sup>

Rasti i Sulejman Pashës që ishte oborrtar me origjinë nga Shqipëria nuk ishte i vetëm. Selman Reis, admirali i parë osman i Suezit ishte grek i islamizuar nga Lesbosi. Sefer Reis, që për shumë vite ushtroi korsarinë në detin Arabik dhe më pas u gradua admiral më 1560 ishte një hebre iberik i islamizuar. Një rast të veçantë e përbëjnë italianët të cilët tërhiqeshin nga karriera në flotën osmane. E njëjta gjë ndodhte edhe me flotat osmane të Mesdheut.<sup>83</sup> Që në vitin 1509, kur portugezi Francisco de Almeida mundi një flotë egjiptiane e përbërë kryesisht nga vullnetarë osmanë në mesin e plaçkave të gjetura në anijet osmane, portugezët për habinë e tyre të madhe gjetën një numër librash në latinisht e italisht, madje edhe një psalter në portugalisht.<sup>84</sup> Hoxha Sefer, nga Otranto, i marrë rob i ri ia doli të bëhej kapedan i galerës së vet dhe më pas shkoi në Indi ku u bë guvernator i Suratit dhe bashkëpunoi gjatë gjithë kohës me Sulejman Pashën gjatë rrethimit të fortesës së Diut.<sup>85</sup> Një portugez çdo vit i sillte Hoxha Seferit në fortesën e tij në Surat letra nga e ëma e tij italiane.<sup>86</sup> Jhangir Khan, një “rum” me origjinë italiane që kishte shërbyer nën sulltanët e Gujaratit, u recitonte robërve portugezë pasazhe të gjata të Petrarkës dhe Ariostos.<sup>87</sup>

<sup>82</sup> “Këta Rumë... kudo që shkojnë menjëherë e quajnë veten Rumë me krenari. Dhe ofendimi më i madh që mund t’u bëhet është ta quash ndonjërin turk, ngaqë i konsiderojnë turqit si më të ulët, të pagdhundur e të përçmueshëm” Couto, *Da Ásia*, vol. 4, libri. 8, kap. 9.

<sup>83</sup> “i numerosi rinnegati, pure partecipando alla vita dei Musulmani, non dimenticavano mai la parlata di origine... Numerosi erano glia Assan, Iussuf, Mami, Morato, Mustafa che si dicevano Genovesi, Napoletani, Ferraresi, Veneziani o Messinesi... e ciascuno di questi rinnegati manteneva ottime relazioni con la famiglia in Italia”. Nullo Pasotti, *Italiani e Italia in Tunisia dalle origini al 1970*, Roma: Finzi editore, 1970, f. 12-13.

<sup>84</sup> Simbas Halil Inalçik, “The Meaning of Legacy: The Ottoman Case”, në *Imperial Legacy: The Ottoman Imprint on the Balkans and the Middle East*, ed. L. C. Brown. New York: Columbia University Press, 1996, f. 19: “The Ottoman Empire was not a “Turkish empire”. It was a multilingual, multireligious, and multicultural political system that is most appropriately to be compared to other empires that have existed throughout the history”.

<sup>85</sup> “Relation of the Expedition of Solyman Pacha from Suez to India against the Portuguese at Diu, Written by a Venetian Officer Who Was Pressed into Turkish Service on that Occasion,” në *General History and Collection of Voyages and Travels...*, ed. Robert Kerr, Edinburgh: William Blackwood, 1824, vëll. 6, f. 268.

<sup>86</sup> Couto, *Da Ásia*, vol. 6, lib. 2, kap. 4.

<sup>87</sup> Couto, *Da Ásia*, vol. 5, lib. 1, kap. 9.

Ekuipezhet e anijeve ishin akoma edhe më të larmishëm etnikisht se sa komandantët e tyre. Kronisti venedikas që mori pjesë në këtë ekspeditë pohon se pashai shqiptar përdori si pretekst shpërthimin e konfliktit me Venedikun më 1537, duke i marrë të gjithë venecianët që gjendeshin në Aleksandri dhe i dërgoi në Kajro ku u zgjodhën artilerët, rremëtarët, marangozët dhe oficerët për t'u dërguar në Suez me qëllim përgatitjen e flotës.<sup>88</sup> Madje edhe 146 portugezë të zënë rob gjatë fushatës u vunë në punë nëpër anije.<sup>89</sup> Mbasi osmanët morën rrugën e kthimit drejt Detit të Kuq garnizoni portugez që mbronte fortesën zuri rob një numër ushtarësh që nuk kishin mundur të hipnin nëpër anije dhe të cilët i identifikuan si grekë, shqiptarë dhe siçilianë.<sup>90</sup>

Gjatë kësaj fushate detare Sulejman Pasha, u tregua një komandant i aftë dhe i mençur. Më vonë kur flota osmane u rikthye nga India dhe u ankorua në Suez admirali shqiptar njoftoi se të gjithë venedikasit e detyruar për të shërbyer në këtë fushatë do të paguheshin njësoj sikur forcat e rregullta osmane.<sup>91</sup>

Por roli i Sulejman Pashës nuk mbaroi me rrethimin e fortesës indiane të Diut. Me urdhër të tij një flotë e vogël osmane nisët për të eksploruar ujrat që gjendeshin më në lindje të Indisë, duke mbërritur në Malajzi e Tajlandë. Në krye të saj Sulejman Pasha caktoi Hajredin Mehmet Reisin. Kapiteni osman është ndarë nga Sulejman Pasha në portin e Diut në Guzerat të Indisë. Duke ndjekur brigjet perëndimore të Indisë (brigjet e Malabarit) ka zbritur nga Diu, në 21 gradë gjerësi gjeografike dhe mbasi ka kaluar ngushticën e Palkut ndërmjet Indisë dhe Cejlonit, ka mbërritur në gjirin e Bengalit. Është ndaluar në Tenaserim në verilindje të gadishullit të Malajës, 12 gradë gjerësi gjeografike, në Burman e sotme. Për shkak të dëmtimit të anijeve gjatë udhëtimit iu bë e pamundur ribashkimi me flotën e Sulejman Pashës dhe u detyrua që t'i

<sup>88</sup> "Relation of the Expedition of Solyman Pacha", f. 259-260; João de Barros, *Quarta década da Ásia. Dos feitos que os portugueses fizeram no descobrimento e conquista dos mares e terras do Oriente*, Em Madrid na Impressão Real, 1615, libri 10, kap. II, f. 638.

<sup>89</sup> "Relation of the Expedition of Solyman Pacha" f. 261-6.

<sup>90</sup> J. Barros, *Quarta década da Ásia...*, libri 10, kap. 1-20. Një kronikë tjetër e kësaj fushate është ajo e një hungarezi që luftonte në anën osmane. István Rákóczi, "Adem Turca e Diu Portuguesa num documento de 1538," në *A Carreira da Índia e as Rotas dos Estreitos: Actas do VIII Seminário Internacional de História Indoportuguesa*, ed. A. T. de Matos and L. F. Thomaz. Angra do Heroísmo: O Seminario, 1998), 519-26.

<sup>91</sup> "Relation of the Expedition of Solyman Pacha", f. 286.

shërbejë mbretit të Siamit me një rrogë të majme duke kryer veprime ushtarake me flotën e tij në Laos.<sup>92</sup> Mbi arsyet që e shtynë shqiptarin Sulejman Pasha të urdhërojë këtë espeditë drejt vendeve më të largëta të Azisë nuk mund të hamendësojmë, por fakti është se ky shqiptar u bë ideatori dhe mbështetësi i udhëtimit më të largët të kryer deri atëherë nga flota osmane në lindje. Kjo ekspeditë e mbështetur prej tij, arrin të njohë dhe të eksplorojë zona të Lindjes së Largët, të cilat prej europianëve vetëm portugezët kishin arritur deri atëherë t'i eksploronin, shumë kohë më përpara se sa anglezët, hollandezët apo francezët.

Në përfundim mund të themi se shembujt e mësipërm, të cilët i kemi për zgjedhur për të ilustruar përmbledhtazi praninë e shqiptarëve në lundrimet mesdhetare dhe oqeanike, si dhe rolin e tyre në zbulimet e mëdha gjeografike të shek. XV-XVI, përbëjnë dëshmi të qarta rreth lidhjes organike të shqiptarëve me detin.

### *S u m m a r y*

#### THE CONTRIBUTION OF THE ALBANIANS TO THE GREAT GEOGRAPHICAL DISCOVERIES (15<sup>TH</sup> -16<sup>TH</sup> CENTURIES)

In this article we bring evidence about the historical relationship between the Albanians and the sea. This is illustrated from their contribution to the Great Geographical Discoveries, through their active participation in the maritime history of the Mediterranean as well as of the Atlantic and of the Indian Ocean. Tracing the life at sea of four great sea admirals of Albanian origin, we bring to light their role in the maritime life of their age. In the case studies presented in this article we analyse their role in the framework of the French Monarchy and of the Ottoman State. It is not by accident that the role of the Albanians in the maritime history of the Mediterranean and beyond, increased from the very start of the 16<sup>th</sup> century. This was due to the fact that the influence of Venice in the Adriatic and the Ionian Sea decreased, bringing to an end the Venetian hegemony in these seas. The geography of the presence of Albanian seamen stretched in these two centuries from the Canary Islands in the Atlantic to the Western Mediterranean and the Red Sea, and even to the Indian Ocean and the Bay of Bengal.

---

<sup>92</sup> Taşkıran, "Les relations ottomano-portugaises au XVI<sup>e</sup> siècle", f. 134-135.